



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
[Tel: +383 38 212 309](mailto:oshp@rks-gov.net) e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 1844/25

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Batisha Ibrahim - Kryetare, Vedat Poterqoi - Anëtar dhe Kimete Gashi-Brajshori- Anëtare të Panelit Shqyrtues, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Komuna Kamenicë, me numër 1844/25, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE Arm Energy Group S h.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me dru për ngrohje: LOT - 1 Furnizim me dru për ngrohje për Institucionet Arsimore dhe LOT – 2 - Furnizim me dru për ngrohje për QKMF-në, me nr: të prokurimit: KM653-25-4820-1-2-1, iniciuar nga Komuna Kamenicë, më: 26.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

1.APROVOHET, si e bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Komuna Kamenicë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “**Arm Energy Group**” S h.p.k, me nr: unik 812219576 - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me dru për ngrohje: LOT - 1 Furnizim me dru për ngrohje për Institucionet Arsimore dhe LOT – 2 - Furnizim me dru për ngrohje për QKMF-në, me nr: të prokurimit: KM653-25-4820-1-2-1, iniciuar nga Komuna Kamenicë dhe i njejtë diskualifikohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik për një periudhë prej tre (3) muajve, nga data: 26.03.2026 deri me 25.06.2026.

A R S Y E T I M

Kërkesa e AK - Komuna Kamenicë:

1. Autoriteti kontraktues pretendon se Operatori Ekonomik “Arm Energy Group Sh.p.”k., si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me dru për ngrohje: LOT - 1 Furnizim me dru për ngrohje për Institucionet Arsimore dhe LOT – 2 - Furnizim me dru

për ngrohje për QKMF-në, me nr: te prokurimit: KM653-25-4820-1-2-1, ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 99 te LPP-se.

2. Autoriteti kontraktues, me tutje ka sqaruar se pas perfundimit te vleresimit ku e kemi rekomanduar per kontrate nje operatore ekonomik tjeter, OE Arm Energy Group S h.p.k ka dorezuar kerkesen per rishqyrtim, ku ne si AK e kemi kthyer ne rivleresim dhe sipas nenit 25 te rregullores i kemi kerkuar deshmit e pranueshmerise, vertetimin e Gjykates kompetente dhe vertetimin e AK-se deshmi te cilat i ka sjell me daten: 06.11.2025 dhe te njejtin sipas procedurave e kemi shpallur fitues per Lot 2.
3. Me daten 13.11.2025, e kemi njoftuar se me daten 19.11.2025 duhet te paraqitet per nenshkrim te kotnrate dhe nga OE Arm Energy Group, kemi prauar nje email, per mes te cilit ka sqaruar se “deri me daten 25.11.2025, gjendet jasht vendit dhe nuk mund te vij para kesaj date”.
4. Autoriteti kontraktues, me tutje ka sqaruar se e kemi njoftuar peresri OE Arm Energy Group se vonesat ne furnizim ndikojn negativisht per shkak se behet fjale per furnizim te QKMF-ve dhe QMF-se.
5. Sipas AK-se, me date 25.11.2025, kemi pranuar email, nga OE Arm Energy Group i cili ka deklaruar se me daten: 27.11.2025, ne ora 10:00 do te vijm per nenshkrim te kontrates.
6. Me daten: 27.11.2025, kemi pranuar email nga OE Arm Energy Group, i cili tani deklaron se “nuk mund te nenshkruajme kontraten per Lot 2, pasi nga ana juaj nuk eshte respektuar vendimi i OSHP-se 746/25 per Lot - 1”.

Mbi bazen e sqarimeve te dhena me larte, autoriteti kontraktues kerkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 te LPP-se me pretendimin se OE PM Group Sh.p.k.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 10.12.2025, te AK - Komuna Kamenicë, e ka njoftuar OE Arm Energy Group Sh.p.k, me qellim qe operatori ekonomik ne fjale te jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE Arm Energy Group Sh.p.k, ne sqarimin e tij ka bere nje pershkrim/kronologji te aktivitetit te prokurimit, duke perfshir ankesen e tij ne OSHP, ekspertizen dhe vendimin e PSH-se nr: 746/25.

Me tutje, OE Arm Energy Group, pretendon se AK-ja, nuk e ka respektuar vendimin e PSH-se dhe duke qene te pakenaqur me keto veprime te AK-se, ne kemi konsideruar te terhiqemi teresisht nga ky aktivitet i prokurimit.

OE Arm Energy Group, ne pergjigjen e dates: 12.12.2025, kryesisht deklarone se nuk e kemi nenshkruar sepse nuk eshte respektuar vendimi i PSH-se per Lot 1 dhe njeherit ka kerkuar qe kerkesa e AK-se per marrjen e masave sipas nenit 99 te LPP-se, te refuzohet si e pa bazuar.

Vlerësimi i pretendimeve te autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj OE Arm Energy Group Sh.p.k:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave paneli shqyrtues vlerëson se

autoriteti kontraktues – Komuna Kamenicë, ka dorëzuar prova që dëshmon se OE Arm Energy Group Sh.p.k, ka mashtruar dhe me kete rast ka vepruar ne kundershtim me nenin 99 te LPP.

Paneli shqyrtues, vlereson se nuk qendron arsyetimi i dhene nga OE Arm Energy Group, se nuk eshte respektuar vendimi i PSH-se, per faktin se ky aktivitet i prokurimit eshte i ndare ne lote ku eshte autoriteti kontraktues e ka rekomandaur per kontrate per Lot 2, ndersa per Lot 1 konform nenit 108/A operatori ekonomik ka mundur ta njoftoj OSHP-ne dhe poashtu te parashtroje ankese ne Organin Shqyrtues te Prokurimit.

Për marrjen e masave ndaj operatorëve ekonomik Organi Shqyrtues i Prokurimit mund veproj vetem nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 te këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, ka dorezuar prova se OE Arm Energy Group Sh.p.k, ka vepruar ne kundershtim me nenin 99 te LPP-se, sepse me veprimet e tij e ka mashtruar autoritetin kontraktues.

Andaj, vleresoj se OE Arm Energy Group Sh.p.k duhet, **të diskualifikohet në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, nga pjesëmarrja në prokurim publik, për te gjitha procedurat e prokurimit, ashtu si është e përcaktuar me nenin 67.9,** Rregullorja për Prokurim Publik Nr. 002/2024, si në vijim” *Në rast se OSHP nxjerr një vendim për diskualifikim të një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në në prokurimin publik prej datës së vendimit. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, “Pjesëmarrja në prokurim publik” është një proces që përfshin tërë ciklin nga njoftimi, aplikimi, përfshirë edhe çfarëdo kundërshtimi apo ankese, deri te vendimi për dhënie të kontratës, rrjedhimisht pamundëson çfarëdo veprimi që Operatori Ekonomik mund të ndërmerr përgjatë tërë procesit të prokurimit prej fazës së publikimit të njoftimit për kontratë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, përfshirë edhe parashtrimin e ankesave. Ky përjashtim vlen për të gjitha llojet e kontratave dhe për të gjitha procedurat e prokurimit”.*

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nenin 99.2 te LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankese, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryetare e Panelit Shqyrtues



Batisha Ibrahim

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Kamenicë

1x1 OE Arm Energy Group Sh.p.k

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.